| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti Filozofik** |
| **Titulli i lëndës:** | **Sociologjia e punës** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **II** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **6** |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimëdhënësi i lëndës:** | **Asst. Dr. Artan Krasniqi** |
| **Detajet kontaktuese:** | **e-mail: artan.krasniqi@uni-pr.edu** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Puna, si aktivitet njerëzor ka pasur dhe ka ndikim në zhvillimin e njeriut dhe shoqërisë. Kursi i Sociologjisë së punës përpiqet të vë në pah rëndësinë e aktivitetit ekonomik si mbështetës i jetës, ndikimin e punës në strukturën sociale dhe kulturën, lidhjen e ngushtë të pabarazive ekonomike me pabarazitë e tjera, si dhe rolin e punës në identitetin personal dhe statusin social.<br>Syllabusi i lëndës është i ndarë në dy pjesë qendrore, ku në pjesën e parë zbërthehen nocionet dhe teoritë kryesore në aspektin historik të ndërlidhur me fenomenin punë, ndërsa pjesa e dytë e syllabusit është më e kontekstualizuar në ndërlidhjen e punës me kategoritë shoqërore, ligjore, ekonomike e të tjera, me fokus në nivel lokal. |
| **Qëllimet e lëndës:** | 1. Të ekzaminojë natyrën e punës si nocion dhe fenomen shoqëror;<br>2. Të ofrojë përmbledhje të dimensioneve historike të punës bazuar në koncepte dhe teori;<br>3. Të hulumtojë mbi ndërlidhjet e fenomenit të punës me kategoritë shoqërore, ligjore, ekonomike e teknologjike në perspektivën aktuale, me theks në shoqërinë kosovare |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje të:<br>1. Njohë konceptet dhe teoritë kryesore mbi punën<br>2. Njohë format e punës dhe organizatës dhe trendet moderne.<br>3. Të kuptojë specifikat e punës ndërlidhur me kategori të ndryshme shoqërore |
| **Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)** | |

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | | | 1 |
| Ushtrime në teren | 1 | 15 | 15 |
| Kollokfiume, seminare | 2 | 5 | 10 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 3 | 6 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 15 | 45 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | | | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | | | 1 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | 2 |
| **Totali** | | | **150** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Ligjërata, seminare, diskutime, punë në grupe etj. |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi i vazhdueshëm:<br><br>35 % testi i parë<br>35 % testi i dytë<br>20 % projekti hulumtues,<br>10 % vijimi i rregullt aktiv. |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | 1. Anthony Giddens, *Sociologjia*, Cabej: Tiranë, 2007<br>2. Max Weber, *Economy and Society: An Outline of Interpretive Sociology*, Univeristy of California Press: Beckerley 1978<br>3. Emile Durkheim, *Ndarja e punës në shoqëri*, Basingstoke, 1984<br>4. Ardian Gola, *Ndarja e punës sipas Smith-it dhe Durkheim-it*, Botimet Pema, Prishtinë, 2019<br>5. Ramush Mavriqi, *Poesis e praxis, Zhvillimi i nocionit të punës prej Aristotelit deri te Hegeli*, Fryma, Pejë, 2005<br>6. Lexime nga *“Libri i Sociologjisë”*<br>*a. Th. Veblen: Konsumi i spikatur i mallrave është një mjet respekti për klasën e ngeshme;*<br>*b. D. Bell: Teknologjia, sikurse arti, është një fluturim i pakufishëm i imagjinatës njerëzore;* |

| | |
|---|---|
| | *c. H. Brevereman: Sa më të sofistikuara të bëhen makinat, aq më pak aftësi zotëron punëtori*<br>*ç. R. Blauner: Automatizimi rrit kontrollin e punëtorit mbi procesin e punës së tij;*<br>*d. K. Kombell: Etika romantike rrit shpirtin e konsumizmit;*<br>*D. Miler: Ne jemi produkte të sendeve, po aq sa ç'janë ato produkte tona.* |
| **Literatura shtesë:** | 1. John Bratton with Militza Callinan, Carolyn Forshaw and Peter Sawchuk, *Work and Organizational Behavior*, Palgrave Macmillan: New York, 2007<br>2. Ian Robertson, *Sociology*, Worth Publishers, Inc: New York, 1987 |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjërata që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | *Prezantimi i planit dhe i metodave të punës.* |
| ***Java e dytë:*** | *Nocioni historik mbi punën* |
| ***Java e tretë*:** | *Koncepti i punës në perspektivën e klasikëve të sociologjisë;* |
| ***Java e katërt:*** | *Ndarja e punës në shoqëri* |
| ***Java e pestë:*** | *Konceptet bashkëkohore mbi punën* |
| ***Java e gjashtë*:** | *Sindikatat dhe konfliktet industriale (zhvillimi i sindikatave, grevat, konfliktet industriale)* |
| ***Java e shtatë:*** | *Korporatat shumëkombëshe, Organizatat dhe fondet ndërkombëtare* |
| ***Java e tetë:*** | *Testi i parë i ndërmjetëm* |
| ***Java e nëntë:*** | *Puna dhe mosha: fëmijët në punë, puna dhe të rinjtë, pensionimi* |
| ***Java e dhjetë:*** | *Puna dhe gjinia (puna e papaguar e grave, rolet gjinore në punë, dallimet në paga)* |
| ***Java e njëmbëdhjetë*:** | *Puna dhe e drejta; Ligji i punës; Mekanizmat e mbikëqyrjes* |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | *Vullnetarizmi; puna në komunitet* |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | *Edukimi, profesionet dhe tregu; Zanatet* |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | *Puna dhe teknologjia: Inteligjenca Artificiale* |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | *Testi i dytë i ndërmjetëm* |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Studentët duhet tu përmbahen këtyre kritereve dhe rregullave të mirësjelljes: vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime, mbajtja e qetësisë në klasë, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj. |